

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2013

I DETYRUAR

VARIANTI A

E premte, 31 Maj 2013

Ora 10.00

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**: 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë: joletrare dhe letrare.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Pikët											
Kërkesa	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikët											
Kërkesa	21a	21b	22	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

Shpirti i botës së gjallë

- 1 Jo shumë larg vendit ku unë jetoj, gjendet një kodër që ndahet në mes nga një përrua. Nga gërryerja e vazhdueshme e ujit është formuar një pjesë toke, në të cilën ka rrënjë të vjetra dhe guralecë që bien shumë në sy. Po ta shohësh nga larg, nuk dallohet gjë tjetër veçse një djerrinë toke e ngritur. Por, kur i afrosh, vëren diçka të mrekullueshme, një strehë të vogël shkëmbore që duket po aq e ndërlikuar dhe e ndërtuar mirë, sa dhe ato që la kultura e lashtë, kur u zhduk në mënyrë misterioze, shekuj më parë. Kjo kodër, e kthyer në mijëra hoje, mund të shfaqej si një qiell i shndritshëm, ku bletët jetonin e ngordhnin. Është një kodër me labirinte. Në të çarat e disa prej gërmimeve dalin gjysmërrathë prej argjili, që u ngjajnë tendave të diellit, të vendosura mbi dyer. Kjo është një tokë e kthyer në argjilë në hojet e bletëve dhe bëhet e dukshme sa herë që ato gërmojnë thellë në strehëzat e tyre.
- 2 Ky është vendi ku bletët kanë strehën e tyre, që i mbron nga shiu, e cila pozicionohet përkarshi diellit të jugut. Pra, është një arkitekturë e gjallë dhe inteligjente, një strehë e ngrohtë, e trashëguar brez pas brezi. Në shumicën e të çarave mund të dallohen ende krahë bletësh të ngordhura, me fytyrat e tyre të thata e të shpërbëra, me sytë e tyre që vështrojnë ngultas nga vendi ku dhanë shpirt, drejt gjysmës tjetër të pabanuar të kodrës, që shtrihet përgjatë përroit, nga katakombet¹.
- 3 Herën e parë që gjeta këtë vendbanim bletësh, ishte verë. Dielli digjte dhe toka kishte marrë ngjyrën e ndryshkut. Tek-tuk, ndonjë makinë zhurmonte përgjatë rrugës së pistë dhe pluhuri ngrihej pas saj, duke u bërë njësh me pluhurin që ishte ngritur aty më parë. Në këtë qetësi dëgjohej zukatja e bletëve. Atëherë ato ishin të gjalla, punonin në kodër e sillnin polenin e luleve në hoje. Ato fluturonin duke bërë një hartë të padukshme në ajër, të skicuar me koordinata, duke komunikuar mes tyre për drejtimin ku ndodhej ushqimi nëpër lule.
- 4 Nën diellin e nxehtë, duke vështruar bletët e vogla që fluturonin përreth kodrës, duke dëgjuar zogjtë e verës e duke ndier flladin e lehtë, ndieja se i përkisja atij vendi. Mendoja për strehëzat e mia, për të vërtetat dhe imagjinaret. Dikur jetoja në një qytet të quajtur Manitou, që do të thotë *shpirti i madh* dhe ku burime të nxehta uji mineral gurgullonin nën rrugët e tij dhe shpërthenin në puse të hapura. Ndihesha e sigurt atje. Lëvizja e nëndheshme e ujit me nxehtësinë, si dhe përfytyrimi mbi një jetë tjetër, atë që ekziston poshtë nesh, të jepnin ndjesinë se aty ishte qendra e botës.
- 5 Vite më vonë, doja vetëm qetësi. Ëndrrat e mia ishin të mbushura me vende ku doja të isha: streha dhe vetmia. Dëshiroja një dhomë të veçuar nga të tjerat, një shtëpizë të fshehtë për të pushuar. Doja të isha në një sekuojë² gjigante pyjore me pemë kaq të larta, sa të dëgjoja zëra kukuvajkash në mes të ditës. Ëndërroja të jetoja në një shpellë, pak orë larg prej këtu. Kam menduar se nëntoka ku është ngrohtë dhe ka lagështirë, do të ishte vendi ideal për t'i qëndruar larg dimrit e për t'iu larguar zhurmës së jetës.
- 6 Kisha dashur shumë herë të arratisesha nga egërsia, në një botë ku njeriu nuk kishte vënë dorë. Por, këto ishin vetëm ëndrra të paqta e të rehatshme të një foleje brenda një guri a druri, një strehë ku ëndrra ose jeta nuk mund të zaptoheshin.
- 7 Në ditë dhe vende të tjera, njerëzit i kushtonin më shumë vëmendje vullnetit kokëfortë të tokës. Dikur, shtëpitë ndërtoheshin prej druri të prerë në një zonë të vetme të pyllit. Mendohej se në këtë mënyrë, shtëpia do të qëndronte në harmoni dhe familja nuk do të shpërbëhej apo nuk do të lejonte që të rrëmbuhej nga grindjet.

¹ katakomb- shpellë e nëndheshme, ku mund të hyhet, por është vështirë të dilet.

² sekuojë- lloj druri, pemë e lartë.

Rrethoni alternativën e saktë për pyetjet nga 1 deri në 7.

1. Cila fjali zbulon më mirë vlerësimin e autores për kodrat? **1 pikë**

- A) Jo shumë larg vendit ku unë jetoj, gjendet një kodër që ndahet në mes nga një përrua.
- B) Në atë kohë, ato ishin të gjalla, punonin në kodër e sillnin polenin e luleve në hoje.
- C) Kjo kodër, e kthyer në mijëra hoje, mund të dukej si një qiell i shndritshëm, ku bletët jetonin e ngordhnin.
- D) Duke vështruar bletët e vogla që fluturonin përreth kodrës, duke dëgjuar zogjtë e verës e duke ndier fladin e lehtë, ndieja se i përkisja atij vendi.

2. Në paragrafin e katërt, *kthimi prapa në kohë* është bërë, kryesisht: **1 pikë**

- A) për të përshkruar qytetin në detaje.
- B) për të shpjeguar kuptimin e emrit të qytetit.
- C) për të përshkruar vendet ku rrëfyesja ndihej e sigurt.
- D) për të shpjeguar arsyet që rrëfyesja kishte për t'u shpërngulur.

3. Në fjalinë: *Një strehë ku ëndrra ose jeta nuk mund të zaptoheshin; folja zaptoheshin* ka kuptimin: **1 pikë**

- A) ndaheshin;
- B) dhunoheshin;
- C) ndërthureshin;
- D) pushtoheshin.

4. Lexoni fjalinë e mëposhtme të paragrafi të fundit. **1 pikë**

Në ditë dhe vende të tjera, njerëzit i kushtonin më shumë vëmendje vullnetit kokëfortë të tokës.

Autorja e përdor personifikimin në këtë fjali:

- A) për të theksuar fuqinë e tokës.
- B) për të theksuar dobitë që sjell toka.
- C) për të demonstruar se toka ka ndryshuar.
- D) për të shpjeguar se toka është një burim i dobishëm.

5. Cila nga alternativat e mëposhtme shfaq më mirë qëndrimin e autores për marrëdhëniet e ndërsjella midis shoqërisë dhe natyrës? **1 pikë**

- A) Doja të isha në një sekuojë gjigante pyjore me pemë kaq të larta, sa të dëgjoja zëra kukuvajkash në mes të ditës.
- B) Lëvizja e nëndheshme e ujit me nxehtësinë, si dhe përfytyrimi mbi një jetë tjetër, atë që ekziston poshtë nesh, të jepnin ndjesinë se aty ishte qendra e botës.
- C) Kam menduar se nëntoka ku është ngrohtë dhe ka lagështirë, do të ishte vendi ideal për t'i qëndruar larg dimrit e për t'iu larguar zhurmës së jetës.
- D) Dikur, shtëpitë ndërtoheshin prej druri të prerë në një zonë të vetme të pyllit.

6. Gjendja shpirtërore e autores, në këtë tekst, është: **1 pikë**
- A) optimiste në lidhje me të ardhmen.
 B) e shqetësuar për dëmtimin e pyjeve.
 C) e dëshiruar për një strehë larg qytetërimit.
 D) e penduar për vendimet e marra në të shkuarën.
7. Si do të ndryshonte ky tekst, nëse do të shkruhej nga një këndvështrim objektiv? **1 pikë**
- A) Ai do të kishte një përmbajtje më pak emocionale.
 B) Ai do të përmbante më pak detaje në lidhje me bletët.
 C) Ai do të përfshinte më shumë informacion në lidhje me rrëfyesin.
 D) Ai do të fokusohet më shumë në të tashmen se në të shkuarën.
8. Ky është një tekst përshkrues. Zbuloni dy karakteristika gjuhësore tipike për llojin e tij. **2 pikë**
- _____
- _____
9. Identifikoni objektin e përshkrimit në paragrafin e parë. Shkruani një shembull të përshkrimit objektiv që lidhet me këtë objekt. **2 pikë**
- Objekti i përshkrimit: _____
- Ilustrimi: _____
10. Identifikoni një folje që shënon shqisën e të parit dhe një që shënon shqisën e të dëgjuarit në paragrafin e tretë. Tregoni rolin që ato luajnë në tekst. **3 pikë**
- Folja për shqisën e të parit: _____
- Folja për shqisën e të dëgjuarit: _____
- Funksioni: _____
- _____
11. Në këtë tekst mbizotërojnë dy kohë foljesh: koha e tashme dhe e pakryer. Shpjegoni funksionin e përdorimit të tyre. **2 pikë**
- _____
- _____

12.

a) Cilat mendoni se janë dy nga arsyet që e shtyjnë autoren të largohet nga realiteti?

2 pikë

b) Cili është mesazhi që përcjell ky tekst.

1 pikë

c) Zbuloni kontrastin në paragrafin e parafundit dhe shpjegojeni atë.

2 pikë

Kontrasti: _____

Shpjegimi: _____

PJESA II**De Rada****Këngët e Milosaos - Kënga XXX**

Fryu era e maleve
dhe rrëzoi hijen e lisit.
Gjaku im te lumi i Vodhit.
Hapeni shatoren,
o ushtarë, që të shoh
Shkodrën edhe time motër
te dritarja kundruall.
Atje nuk do zgjohem më
luleve që i tund era
si suvalë e pasosur.
Mblidhen shokët mbrëmanet
në katund, në vatërët.
Unë i lashë si ëndërrëz.

Rrethoni alternativën e saktë për pyetjet nga 13 deri në 18.

13. Në këngën XXX tregohet për:

1 pikë

- A) flijimin dëshpërues të heroit që humbi familjen.
- B) dëshirën e heroit për të shlyer gabimin e bërë dikur.
- C) amanetin e fundit të Milosaos për t'u varrosur pranë familjes.
- D) çastet e fundit të Milosaos së plagosur.

14. Kjo këngë përshkohet nga nota:

1 pikë

- A) pendimi;
- B) trishtimi;
- C) ekzaltimi;
- D) triumfi.

15. Vargu: *Mblidhen shokët mbrëmanet*; nënkupton:

1 pikë

- A) jetën që do të vazhdojë edhe më pas.
- B) mbrëmjet e qeta të katundit.
- C) bisedat që do të bëhen për të rënë.
- D) jetën e qetë që do të ketë ky vend.

16. Figura e stilistikës në vargun: *dhe rrëzoi hijen e lisit*; është:

1 pikë

- A) metafora;
- B) metonimia;
- C) krahasimi;
- D) epiteti.

17. Në vargun: *te dritarja kundruall*; fjala *kundruall* ka kuptimin:

1 pikë

- A) tjetër;
- B) e hapur;
- C) përtej;
- D) përballë.

18. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme është përdorur një trajtë dialektore?

1 pikë

- A) Atje nuk do të zgjohem më.
- B) Luleve që i tund era.
- C) Unë i lashë si ëndërrëz.
- D) Në katund, në vatërët.

19. Përshkruani atmosferën që sundon në këtë këngë. Tregoni funksionin artistik të këtij përdorimi.

3 pikë

Atmosfera: _____

Funksioni: _____

20. Në vargun e tretë të kësaj kënge mungon një nga gjymtyrët kryesore të fjalisë. Cila është ajo? Rishkruajeni vargun duke e shtuar këtë gjymtyrë të nënkuptuar.

2 pikë

21.

a) Çfarë kërkon Milosao të shohë në fund dhe pse? Ç'ndjenjë e përshkon heroin në këto vargje?

3 pikë

b) Zbuloni në këtë këngë një tipar të Milosaos që e bën atë një hero romantik.

1 pikë

22. Gjeni kohën e foljeve në vargjet e mëposhtme. Shpjegoni këtë përdorim në funksion të idesë që mbartin vargjet përmbyllëse të kësaj kënge.

3 pikë

*Mblidhen shokët mbrëmanet
në katund, në vatërët.
Unë i lashë si ëndërrëz.*

23. Çfarë ka të veçantë nga mënyra e ndërtimit (fjalëformimit) fjala *ëndërrëz*? Shpjegoni përfytyrimin që ajo krijon.

2 pikë

24. Ç'përfaqëson imazhi i malit dhe i lisit në këtë këngë?

1 pikë
